



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:050699

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05459348

P.nr.267/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- Departamenti i Përgjithshëm Penal, gjyqtari gjykues Fatmir Krasniqi, me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarëve **V.K.**, nga fsh.Petrove, Komuna e Prizrenit, me mbrojtësin e tij **av.H.S.**, nga Prizreni, dhe i akuzuari **Sh.K.**, nga fsh.Petrove, Komuna e Prizrenit, me mbrojtësin e tij **av.K.K.**, nga Prizreni, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par.1 të KP-es, dhe vepra penale e kanosjes nga neni 181 par.2 të KP-se, të akuzuar me aktakuze PP.nr.234-5/2024 të datës 05.03.2024, me datë **15.03.2024** morri këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET, marreveshja për ndermjetesim e lidhur në mes të akuzuarëve **V.K.**, nga fsh.Petrove, Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, dhe të akuzuarit **Sh.K.**, nga fsh.Petrove, Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, të ndermjetesuesit, në qendrën e ndermjetesimit në Prizren Ndm.nr.92/2024 të dt.11.03.2024.

HUDHET aktakuza dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të akuzuarëve **V.SK.**, fsh.Petrove Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, dhe të akuzuarit **Sh.K.**, nga fsh.Petrove, Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par.1 të KP-es, dhe vepra penale e kanosjes nga neni 181 par.2 të KP-se

Në kuptim të nenit 12.5 dhe 14.4 të Ligjit për ndermjetesim.

Shpenzimet procedurale bijnë në barrë të mjeteve bugetore të kësaj gjykate.

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Prizren pranë Gjykatës Themelore – departamenti i përgjithshëm në Prizren, ka parashtruar aktakuze PP.nr.234-5/2024 të dt.05.03.2024, kundër të akuzuarëve **V.K.**, dhe

Sh.K., qe te dy nga fsh.Petrove, Komuna e Prizrenit, për shkak të vepres penale për shkak të vepres penale kanosje nga neni 181 par.1 te KP-es, dhe vepra penale e kanosje nga neni 181 par.2 te KP-se

Gjykata ka caktuar seancen e shqyrtimit gjyqesor fillestar per dt.11.03.2024, ne te cilen seance kane prezentuar palet ne procedure dhe ate prokurori themelor i shtetit Naim Gashi, te akuzuarit V, e Sh.K., qe te dy nga fsh.Petrove, Komuna e Prizrenit,

Me propozimin dhe pajtimin e paleve, te akuzareve, te cilet i kane propozuar gjykates qe kete çeshtje te dergoj ne proceduren e ndermjetesimit dhe pas dhenjes se mendimit dhe pajtimit nga prokurori themelor i shtetit Naim Gashi, gjykata me aktvendim e pranoj propozimin e paleve ne baze te ligjit te ndermjetesimit dhe dispozitave te KPPK-es.

Me dt.11.03.2024 ne qendren e ndermjetesimit ne Prizren me nr.reference Ndm.nr.92/2024, eshte lidhur marreveshja per zgjidhjen e ndermjetesuar ndermjet te akuzareve V.K., dhe Sh.K.,.

Gjykata pas shiqimit dhe vleresimit te marreveshjes per ndermjetesim konstatoi se palet pa ndonje kercnim dhe me vet deshire kane shprehur gadishmerin qe kjo çeshtje te zgjidhet me ndermjetesim dhe nuk kane kontestuar asnje nga pikat e marreveshjes se ndermjetesimit, andaj vendosi qe te aprovoj marreveshjen si te bazuar.

Andaj Gjykata në kuptim te nenit 358 par. 1, nenpar.1.3 të KPP-se, e lidhur me nenin 12.5 dhe 14.4 te Ligjit per ndermjetesim dhe nenit 181 par.1 dhe 181 par.2 te KPKse, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muarr në kuptim të nenit 454 par.2 të KPPK-ës.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i pergjithshem penal
P.nr.267/2024 te dt.15.03.2024

Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari

Gjyqtari
Fatmir Krasniqi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa